

UNIVERSITETI I PRISHTINËS

“HASAN PRISHTINA”

FAKULTETI I INXHINIERISË MEKANIKE

DREJTIMI: KONSTRUKSION DHE MEKANIZIM

STUDIME PASDIPLOMIKE



PUNIM DIPLOME (MASTER)

Mentori:

Prof. Dr. Musli BAJRAKTARI

Kandidati:

Inxh. Dip. Zenel SEJFIJAJ

Prishtinë, 2017

UNIVERSITETI I PRISHTINËS

“HASAN PRISHTINA”

FAKULTETI I INXHINIERISË MEKANIKE

DREJTIMI: KONSTRUKSION DHE MEKANIZIM

STUDIME PASDIPLOMIKE



PUNIM DIPLOME (MASTER)

**Tema: HULUMTIMI I NDIKIMIT TË ELEMENTEVE KONSTRUKTIVE NE
KAFAZIN E GJELBËRT NË MINIERËN “TREPÇA” – STAN TËRG**

LËNDA: Projektimi i mjeteve transportuese

Mentori:

Prof. Dr. Musli BAJRAKTARI

Kandidati:

Inxh. Dip. Zenel SEJFIJAJ

Prishtinë, 2017

PËRMBAJTJA

LISTA E FIGURAVE	IV
LISTA E TABELAVE	VI
LISTA E VIZATIMEVE	VII
FALËNDERIM.....	VIII
PËRMBLEDHJE.....	IX
1 HYRJE.....	1
1.1. MOTIVIMI	2
1.2. PËRSHKRIMI I PROBLEMIT	2
1.3. STRUKTURA E PUNIMIT.....	3
2 NJOHURI TE PËRGJITHSHME PËR PAJISJET NGRITËSE TË MINIERËS.....	4
2.1 KAFAZET PËR BARTJEN E NJERËZVE NË PUSIN KRYESOR	6
2.2 SKIPAT E XEHES NË PUSIN KRYESOR.....	9
2.3 KAFAZI NË PUSIN E VERBËR	10
3 LLOGARITJA E KAFAZIT TË GJELBËRT PËR BARTJE TË NJERËZVE DHE MATERIALEVE TË NDRYSHME.....	13
3.1 PAJISJA LIDHËSE	14
3.1.1 Shufra e mbretit, kryqi, lidhëset, zemra dhe spinotat	15
3.1.2 Shtrëngueset e litarit	15
3.1.3 Zinxhirët sigurues	15
3.2 PAJISJA PËR KAPJEN E KAFAZIT	16
3.2.1 Susta	16
3.2.2 Levat, trau, kthetrat.....	16
3.3 VERIFIKIMI STATIK I KAFAZIT PËR BARTJEN E NJERËZVE DHE MATERIALIT	16
3.3.1 Llogaritja e elementeve të veçanta të kafazit gjatë transportit të materialit	17
3.3.2 Llogaritja e mbajtësve të etazhes së kafazit.....	17
3.3.3 Llogaritja e shufrave anësore 1 dhe 2.....	20
3.3.4 Llogaritja e mbajtësit kryesor të kafazit (9).....	21
3.4 LLOGARITJA E ELEMENTEVE TË VEÇANTA GJATË TRANSPORTIT TË NJERËZVE.....	24

3.5	KOKA E KAFAZIT.....	25
3.5.1	Llogaritja e lidhjeve të salduara.....	26
3.6	PAJISJA LIDHËSE	29
3.6.1	Shufra e mbretit	29
3.6.2	Kryqi dhe lidhëset.....	31
3.6.3	Aksëzat-spinotat	32
3.6.4	Mbështetësi kryesor i shufrës së mbretit	33
3.7	KAPSËT	33
3.7.1	Susta me fletë	33
3.7.2	Pyka në shufrën e mbretit.....	36
3.7.3	Mbështetësi i sustës	36
3.7.4	Leva në shufrën e mbretit.....	38
3.7.5	Lidhëset	38
3.7.6	Aksëzat	39
3.7.7	Leva në traun mbajtës.....	39
3.7.8	Trau.....	40
4	RREGULLATIVA LIGJORE DHE AJO TEKNIKE NË TË CILËN ËSHTË BAZUAR LLOGARITJA DHE TESTIMI I PAJISJES NGRITËSE	41
4.1.	KAFAZI	41
4.2.	KAPSET (PARASHUTAT) E ENËVE NGRITËSE.....	42
4.3.	PAJISJA LIDHËSE (VARËSET).....	43
5	PROCEDURA E EKZAMINIMIT TË LITARIT	46
5.1	STANDARDET E APLIKUARA	46
5.2	TË DHËNAT PËR LITARIN E EKZAMINUAR	49
5.2.1	Lloji /Standardi:	49
5.2.2	Diametri i litarit:	49
5.2.3	Konstruksioni i litarit:.....	49
5.2.4	Konstruksioni i tufës së litarit.....	49
5.2.5	Diametrat e telave dhe bërthamës në tufë:.....	50

5.3	EKZAMINIMI I LITARIT	51
5.3.1	Shikimi vizual.....	51
5.3.2	Provat - ekzaminimet në laborator.....	51
5.4	FORCA NOMINALE E KËPUTJES	67
5.5	TELAT TË CILËT NUK MERREN NË LLOGARITJE	67
5.6	FORCA E PËRGJITHSHME ZBRITËSE E CILA ËSHTË HEQUR NGA LLOGARITJA	68
5.7	FORCA BARTËSE E LITARIT ME MATJE	68
5.8	KONSTATIMI PËR LITARIN E EKZAMINUAR	68
6	ANALIZA E PUNËS SË KAFAZIT TË GJELBËRT PAS LËSHIMIT FILLESTAR NE PUNË	69
6.1	PROVAT STATIKE	69
6.1.1	Ngarkesa provuese 1.....	69
6.1.2	Ngarkesa provuese 2.....	70
6.1.3	Konstatim për provat statike.....	70
6.2	PROVAT DINAMIKE.....	70
6.2.1	Prova pa ngarkesë.....	71
6.2.2	Prova me ngarkesë.....	71
6.3	SIMULIMI KUR NDËRPRITET RRYMA	74
6.3.1	Simulimi pa ngarkesë	74
6.3.2	Simulimi me ngarkesë	75
6.4	FUNKSIONIMI I NOFULLAVE TË PARASHUTAVE.....	77
6.4.1	Prova me bllokim të kafazit me trarët	77
6.4.2	Prova me ndarje të plotë të litarit nga kafazi	78
7	PËRFUNDIMI	82
7.1	REKOMANDIMET	83
8	LITERATURA.....	84
	PJESA GRAFIKE	86

LISTA E FIGURAVE

Figura 2.1: Preja tërthore e pusitë, enëve ngritëse dhe pajisjeve të pusit në.....	6
Figura 2.2: Gjendja e kafazit të gjelbërt në pusin kryesor.....	8
Figura 2.3: Kafazi i ri i prodhuar në Fabrikën e Pajimeve në Mitrovicë.....	8
Figura 2.4: Makina ngritëse për lëvizjen e kafazit.....	9
Figura 2.5: Kafazi i ri i rikonstruktuar	10
Figura 2.6: Tamburi ngritës i kafazit.....	10
Figura 2.7: Makina ngritëse për ngritjen e skipeve.....	11
Figura 2.8: Prerja tërthore e pusit të verbër.....	11
Figura 2.9: Kafazi në pusin e verbër TK01.....	12
Figura 2.10: Kafazi në pusin e verbër TK02 dhe TK 03.....	12
Figura 3.1: Paraqitja skematike e konstruksionit bazë të kafazit.....	18
Figura 3.2: Paraqitja skematike e sistemit të mbajtësve.....	18
Figura 3.3: Prerja tërthore e profileve te përforcuar me lamela.....	20
Figura 3.4: Mbajtësi 3 dhe 5.....	21
Figura 3.5: Forcat ne shufrat e veçanta.....	21
Figura 3.6: Ngarkesa në mbajtësin kryesor.....	23
Figura 3.7: Shpërndarja e njëtrajtshme e ngarkesës.....	25
Figura 3.8: Konstruksioni shtesë në mbajtësin kryesor.....	26
Figura 3.9: Shputa (prerja 4-4).....	28
Figura 3.10: Shufra e mbretit.....	30
Figura 3.11: Presionet sipërfaqësore në shufrën e mbretit.....	31
Figura 3.12: Verifikimi i shufrës së mbretit.....	32
Figura 3.13: Aksëza - spinoti.....	33
Figura 3.14: Mbështetësi kryesor i shufrës së mbretit.....	34
Figura 3.15: Susta me fletë.....	34
Figura 3.16: Susta e kafazit.....	35
Figura 3.17: Pyka në shufrën e mbretit.....	37
Figura 3.18: Buloni.....	38
Figura 3.19: Leva në shufrën e mbretit.....	39

Figura 3.20: Aksëzat.....	40
Figura 3.21: Leva në traun mbajtës.....	40
Figura 3.22: Trau mbajtës.....	41
Figura 5.1: Konstruksioni i litarit.....	50
Figura 5.2: Litarët me tufa rrethore.....	51
Figura 5.3: Matja e diametrit të litarit.....	53
Figura 5.4: Makina për provën në tërheqje: Inspekt 100, Hegewald & Peschke.....	54
Figura 5.5: Diagrami forcë – zgjatim i disa telave të tufës së I-rë të ekzaminuar.....	56
Figura 5.6: Diagrami forcë – zgjatim i disa telave të tufës së II-të të ekzaminuar.....	56
Figura 5.7: Skema parimore e përkuljes.....	63
Figura 5.8: Pajisja për provën e përkuljes së shumëfishtë.....	64
Figura 5.9: Parimi i punës së përkuljes së shumëfishtë: 1. Kampioni, 2. dorëza, 3. udhëzuesja, 4. cilindri i majtë, 5. cilindri i djathtë dhe 6. nofulla shtrënguese.....	64
Figura 6.1: Vagonët e mbushur me rërë për provë.....	71
Figura 6.2: Paletat e mbushura me thasë çimento.....	71
Figura 6.3: Vagoni i ngarkuar në katin 1 të kafazit.....	72
Figura 6.5: Makina ngritëse.....	76
Figura 6.6: Trau me dërrasën.....	78
Figura 6.7: Pamja e nofullave pas veprimit.....	78
Figura 6.8: Përforcimi i litarit.....	79
Figura 6.9: Aksëza ndarëse.....	79
Figura 6.10: Pamja e çengelit special i montuar dhe i gatshëm për veprim.....	80
Figura 6.11: Pamja e nofullave para veprimit.....	80
Figura 6.12: Gjatësia e rrugës së ngërthit të kafazit.....	81

LISTA E TABELAVE

Tabela 5.1: Toleranca e diametrit tërthor të litarit të ri sipas DIN 1506.....	53
Tabela 5.2: Vlerat e lejuara të diametrave të telave të litarit.....	53
Tabela 5.3: Forcat këputëse të telave të litarit të fituar me matje.....	55
Tabela 5.4: Telat të cilët duhet hequr nga llogaria e forcës këputëse të matur në laborator për shkak të diametrave jo të lejuar.....	57
Tabela 5.5: Forca këputëse mbledhëse (e përgjithshme) e matur për tufa dhe telat e tufës.....	58
Tabela 5.6: Qëndrueshmëria në tërheqje mbledhëse e matur për tufa dhe telat e tufës.....	58
Tabela 5.7: Qëndrueshmëria e matur në laborator e cila duhet zbritur R_{Zd} për shkak të diametrave jo të lejuar.....	59
Tabela 5.8: Vlerat e qëndrueshmërisë mesatare R_{mes} sipas diametrave të telave.....	60
Tabela 5.9: Vlerat e qëndrueshmërisë maksimale dhe minimale të lejuar.....	61
Tabela 5.10: Telat të cilët duhet hequr nga llogaritja e qëndrueshmërisë të matur në laborator për shkak të qëndrueshmëria mesatare jo të lejuara.....	62
Tabela 5.11: Numri minimal i lejuar i përkuljeve.....	65
Tabela 5.12: Diametrat e rulit në varësi nga diametri i telit.....	66
Tabela 5.13: Telat të cilët duhet hequr nga llogaritja e litarit për shkak të përkuljeve më të vogla se ato të lejuara si dhe forca këputëse e tyre.....	66
Tabela 5.14: Kushti i cili duhet plotësuar për qëndrueshmëri dhe përkulje të dyfishta.....	68
Tabela 5.15: Forca nominal këputëse për diametrat nominal të telave të litarit.....	68

LISTA E VIZATIMEVE

Vizatimi A0.001: Pusorja në minierën “Trepça” – Stan Tërg.....	001
Vizatimi A0.002: Kafazi i Ri-konstruktuar.....	002
Vizatimi A0.003: Pajisjet lidhëse dhe për frenim.....	003
Vizatimi A2.001: Pajisjet lidhëse.....	004
Vizatimi A2.002: Pjesa e zemrës.....	005
Vizatimi A1.001: Shufra e Mbretit.....	006
Vizatimi A2.003: Pajisjet lidhëse të Shufra e Mbretit.....	007
Vizatimi A1.002: Elementi lidhës.....	008
Vizatimi A1.003: Elementi lidhës 1.....	009
Vizatimi A1.004: Elementi lidhës 2.....	010
Vizatimi A2.004: Konstruksioni mbajtës i kafazit.....	011

FALËNDERIM

Me shumë kënaqësi do të doja të shprehja falënderimet e mia të sinqerta për të gjithë ata që më ndihmuan, konsultuan dhe më mbështetën moralisht gjatë realizimit të këtij punimi të Masterit. Së pari falënderoj mentorin e këtij punimi Prof. Dr. Musli BAJRAKTARI, i cili me kontributin e tij shkencor dhe metodik, më ka qëndruar pranë, më ka nxitur, motivuar e ndihmuar gjatë gjithë periudhës së punës për realizimin e këtij punimi. Falënderime meritojnë gjithashtu edhe anëtarët tjerë të komisionit Prof. Asoc. Dr. Naser Lajqi dhe Prof. Asoc. Ahmet Shala për këshillat dhe sugjerimet me qellim që punimi i Masterit të merr këtë formë.

Pra, përfundimi i këtij punimi do të ishte pothuajse i pa mundur pa ndihmën e të tjerëve, andaj dëshiroj t'i falënderoj të gjithë ata të cilët kanë më kanë ndihmuar që ky punim Masteri ta marrë formën të cilën e ka sot. Falënderoj Fakultetin e Inxhinierisë Mekanike për kushtet e ofruara gjatë përfundimit të studimeve të mia.

Po ashtu falënderoj edhe Komisionin e Pavarur për Miniera dhe Minerale, Ministrinë e Zhvillimit Ekonomik, Ndërmarrjen "Trepça" Stan-Tërg për ofrimin e të dhënave dhe ndihmën e tyre.

Së fundmi falënderimet e mia i takojnë familjes sime, që me durim e përkushtim më kanë kuptuar, nxitur dhe ndihmuar në përfundimin e studimeve Master.

PËRMBLEDHJE

Pajisjet ngritëse te minierës shërbejnë për ngritjen dhe lëshimin e minatorëve dhe mineralit nga horizontet e ndryshme te minerareve në sipërfaqe. Pajisjet ngritëse përbehen nga: makina ngritëse, litarët ngritës, enët ngritëse - kafazet, pajimet e pusit, kulla e minierës me rrotat për mbajtjen dhe drejtimin e litarëve dhe pajisjet ndihmese te ngarkim-shkarkimit.

Makinat ngritëse qe përdoret ne minierën e Stan Tërgut janë me tambure cilindrike për bartjen e materialit dhe njerëzve me origjinë nga SHBA-ja, prodhuar në vitin 1950 nga “VULCAN IRON WORKS“ dhe lëshuar në punë në vitin 1954. Qe nga viti 1954 makina ngritëse funksionon edhe sot, por i nënshtrohet testimeve sipas rregullativave teknike dhe masat mbrojtëse në punë gjatë levizjës së njerëzeve dhe materialit në miniera.

Ena ngritëse lidhet përmes litarit me makinën ngritëse. Për bartje te materialit si enë ngritëse përdoret skipi. Ndërsa për bartjen e minatorëve dhe materialeve te tjera si ene ngritëse përdoren kafazet. Ne ketë punim të Masterit do të analizohet kafazi i gjelbër, litari i tipit Warington me diametër Ø38 [mm] dhe makina ngritëse. Kafazi i gjelbër i cili ka qenë ne përdorim deri në vitin 2005, pas kontrollit detajor është larguar prej përdorimit, dhe është zëvendësuar me një kafaz tjetër te prodhuar në Fabrikën e Pajimeve të Procesit në Mitrovicë.

Secila pjesë e kafazit të gjelbër paraprakisht është llogarit për ngarkesa statike dhe dinamike. Pas vendosjes se tij në pusore janë bërë testimet në bazë të Rregulloreve teknike dhe masave mbrojtëse në punë gjatë lëvizjes së njerëzve dhe mineraleve.

Ne punim do te hulumtohen faktorëve të cilët duhet te merren parasysh gjatë llogaritjes se konstruksionit të kafazit, litarit. Gjithashtu do te tregohen metodat te cilat përdoren gjatë testimit te litarit dhe makinave ngritëse.

Ne punim gjithashtu është treguar procedura e testimit dhe kontrollimit të litarit, sa i përket kohës se përdorimit bazohet ne rregullore, ndërsa mënyra e testimit te tyre është e bazuar ne standarde.

1 HYRJE

Miniera “Trepça” është ndërmarrje e vjetër e themeluar nga anglezët e cila është aktivizuar në vitin 1927, ndërsa me prodhim ka filluar në vitin 1930, si rezultat i kërkimeve gjeologjike të filluara 6 vite më parë. Miniera “Trepça” në Stan Tërg shtrihet 10 km në verilindje të Mitrovicës.

Miniera aktualisht i ka 11 horizonte aktive dhe 125 punishte. Inovacionet teknologjike të realizuara në periudha të ndryshme kryesisht kanë qenë me inventarizimin e minierës me skreperë, autolloderët, makinat shpuese me “këmbë” pneumatike, përdorimi i ujit gjatë shpimit për ç’pluhrosje, etj.

Në vitin 1953, udhëheqja e minierës vendosë që të hapet pusi i ri nga sipërfaqja, duke e thelluar deri në nivelin e horizontit IX. Pusi i ri është hapë në pjesën tavanore të trupit xeheror dhe njëkohësisht hapet edhe pusi qorr, nga horizonti V deri në horizontin X. Nga pusi qorr zhvillohen punimet në hapjen e horizonteve të reja, duke e zhvilluar korridorin kryesor dhe duke i hapë objektet për akumulimin e ujit dhe objektet e pompimit të ujit. Në këtë mënyrë hapen dy nga dy horizonte të reja (VIII dhe IX në një cikël dhe i X dhe XI në ciklin tjetër).

Pajisjet ngritëse që përdoren për ngritjen dhe lëshimin e minatorëve, pajisjeve punuese dhe materialeve të nevojshme përbehen nga: makina ngritëse me dy tambur (TM dhe TD) për mbështjelljen e litarit për ngritje të njerëzve, litarët ngritës, kafazeve me dy kate (të gjelbërit dhe të kuqit), traversave dhe drejtuesve të drurit, kulla e minierës me rrotat për mbajtjen dhe drejtimin e litarëve dhe pajisjet ndihmëse të ngarkim-shkarkimit. Këto pajisje janë shumë të vjetra, punojnë prej vitit 1954 të cilat janë të konsumuara dhe të dëmtuara nga korrozioni dhe faktorët e tjerë ndikues. Produktiviteti i tyre është i vogël kur merret parasysh teknologjia e

punimit të tyre. Numri i kontrollove duhet të jetë i madh me qëllim të rritjes së sigurisë së punës. Të dy kafazet janë zëvendësuar me kafaze të punuara në Fabrikën e pajimeve të procesit në Mitrovicë. Masa e kafazit të ri ka qenë më e madhe se ajo e kafazit të montuar në vitin 1954 për shkak të trashësisë me të madhe të profileve dhe llamarinave. Gjatë testimeve të bëra me kafazin e ri janë vërejt goditje të rrëshqitësve të kafazit me drejtueset. Shufra e mbretit si pajisje e atestuar është siguruar nga importi. Kualiteti i materialit të telave të litarëve gjatë mbështjellës se litarit me tambur ka krijuar probleme të shumta që janë manifestuar me vibracione të mëdha të makinave ngritëse dhe me këputjen e telave të litarit. Ndërhyrje të shpeshta ka pas në drejtuese për shkak të rrëshqitësve anësor të kafazit.

1.1. Motivimi

Për rritjen e sigurisë së pajisjeve ngritëse e posaçërisht kafazit të gjelbërt i cili ka qenë në eksploatim për me shumë se 50 vite është dashur të behët zëvendësimi i kafazit ekzistues me kafaz të ri. Qëllimi kryesor i këtë punimi është hulumtimi i faktorëve të cilët duhet të merren parasysh gjatë llogaritjes statike të konstruksionit bartës të kafazit të gjelbërt. Kafazi i gjelbërt është i destinuar për transportin e njerëzve dhe të mallrave në minierë. Meqenëse përcaktimi kryesor i kafazit është transporti i njerëzve dhe mallrave, atëherë siguria për të duhet të jetë jashtëzakonisht e lartë.

Prandaj duke pasur parasysh rendësin e kafazit dhe lidhshmërinë e punës sime si Inspektor i minierave në kuadër të Komisioni i Pavarur i Minierave dhe Mineraleve, jam jashtëzakonisht i motivuar që të merrem me hulumtimin e faktorëve që ndikojnë drejtpërsëdrejti në rritjen e sigurisë së tij me qëllim të parandalimit të aksidenteve të mundshme.

1.2. Përshkrimi i problemit

Kafazi i gjelbërt i cili ndodhet në minierën e Stan Tërg-ut ka qenë në eksploatim për me shumë se 50 vite dhe për shkak të rritjes së sigurisë në punë është bërë zëvendësimi i tij. Pas largimit të kafazit ekzistues nga pusorja, konstruksioni tij bartës ka qenë i dëmtuar nga korrozioni dhe lodhja e materialit. Trashësia e korrozionit në disa pika të veçanta të matjes ka pas trashësinë prej rreth 2 [mm].

Elementet përbërëse të kafazit janë mbajtësit e kateve (etazhave), shufrat anësore, mbajtësi kryesor, koka e kafazit dhe pajisjet lidhëse (posaçërisht shufra e mbretit). Për secilin

element është e përcaktuar shkalla e sigurisë si për rastin e bartjes së njerëzve dhe mallrave. Fillimisht është llogarit konstruksioni mbajtës i kafazit. Vlerat e shkalles së sigurisë së elementeve të kafazi duhet të ketë vlerë > 7 herë.

Freni sigurues (parashuta me nofulla) e cila është e montuar në shufrën e mbretit ka qenë jashtë funksionit. Ndërsa për shufrën e mbretit shkalla e sigurisë duhet të jetë > 7 respektivisht rekomandohet të jetë rreth 13 herë.

Siguria e litarit arrihet përmes kontrolleve vizuale periodike, metodave të testimit pa shkatërrim dhe me shkatërrim. Litari bartës është i tipit Warington dhe duhet të ketë siguri të lartë pasi që përmes tij bëhet bartja e minatorëve. Atestimet e litarëve behën përmes procedurës së paraparë me standard. Duke filluar me ndarjen e tufave nga litari, për të vazhduar me ndarjen e telave nga litari. Secili tel testohet në tërheqje dhe në përkulje të shumëfishtë.

Makina ngritëse i nënshtrohet testeve pa shkatërrim, për të vërtetuar qarjet dhe dëmtimet eventuale.

Prandaj sipas rregulloreve të minierave kërkohet që kafazi të nënshtrohet kontrollit vizual dhe atesteve nga institutet që merren me vërtetimin e qëndrueshmërisë së tij. Gjithashtu duhet bërë kontrollet periodike të akseve dhe boshteve të makinës ngritëse.

1.3. Struktura e Punimit

Në fillim të punimit është dhënë falënderimi dhe përmbledhja e punimit. Gjithashtu në fillim është dhënë përmbajtja, lista e figurave, dhe shkurtesave të përdoruar në punim.

Në kapitullin e parë është prezantuar hyrja, motivimi, përshkrimi i problemit dhe struktura e punimit.

Kapitulli i dytë ka të bëjë me njohuri të përgjithshme për pajisjet ngritëse të minierës.

Kapitulli i tretë ka të bëjë me llogaritjen e kafazit të gjelbër për bartje të njerëzve dhe materialeve të ndryshme.

Kapitulli i katërt ka të bëjë me Rregullativat ligjore dhe teknike në të cilat bazohet llogaritja dhe testimi i pajisjeve ngritëse.

Kapitulli i pestë ka të bëjë me procedurën e ekzaminimit të litarit.

Kapitulli i gjashtë ka të bëjë me analizë të punës së kafazit të gjelbër pas lëshimit fillestar në punë. Këtu është përshi: prova statike, prova dinamike, simulimi kur ndërpritet rryma dhe funksionimi i kthetrave të parashutave.

Kapitulli i shtatë ka të bëjë me përfundimin.

2 NJOHURI TE PËRGJITHSHME PËR PAJISJET NGRITËSE TË MINIERËS

Pajisjet ngritëse të minierës përbehen prej këtyre pjesëve: makina ngritëse, litarët ngritës, enët ngritëse, pajimet e pusit, kulla e minierës me rrotat për mbajtjen dhe drejtimin e litarit dhe pajisjet ndihmese të ngarkim-shkarkimit.

Me ndërmjetësimin e makinave ngritëse bëhet lidhja e punimeve nëntokësore të minierës me sipërfaqen. Prandaj, makinat ngritëse mundësojnë ngritjen e të gjitha prodhimeve minerare.

Litarat mundëson lidhjen e makinës ngritëse me enët ngritëse. Enët e zakonshme ngritëse që përdoren në puset vertikale të minierës janë kafazet dhe skipet. Kafazet përdoren për ngritjen dhe zbritjen e punëtorëve, furnizim të minierës me material ndihmës (vegleri, eksploziv, vajra e tjera), makina dhe pajisje të tjera (çekiçë shpues, argen, lokomotiva, skreper e të tjera). Kafazet mund të përdoren edhe për bartjen e vagonëve që ngarkohen dhe shkarkohen në sheshet e pusit bëjnë të mundur ngritjen e materialit (xeherorit dhe shterpës) nga nëntoka në sipërfaqe. Skipet përdoren për ngritjen e xeherorit nga nëntoka.

Minierat e mëdha pajisen më së paku me dy makina ngritëse: njëra për ngritjen e materialeve (mineraleve) të dobishme me skipe, kurse tjetra për plotësimin e funksioneve ndihmese, e pajisur me kafaze.

Drejtonjëset dhe traversat përbejnë skeletin e brendshëm të pusit ngritës. Drejtonjëset vendosen paralel me aksin e pusit dhe shërbejnë për udhëzimin dhe lëvizjen e qetë të enës ngritëse nëpër brendinë e pusit. Traversat vendosen nën kënd të drejt me drejtonjëset në një distancë të caktuar gjatë aksit vertikal të pusit.

Miniera është e thelluar me pusin kryesor, të pozicionuar në pjesën jugperëndimore të trupit xeheror. Ky pozicion i pusit është përcaktuar nga struktura e shkëmbinjve të llojit shist në të cilët do të duhej të shtrihet pusi, nga shkaku që shkëmbinjtë shist janë izolator të mirë të ujit.

Pusi kryesor është thelluar nga sipërfaqja (kota 780 m të lartësisë mbidetare), deri në -5 m nën nivelin e horizontit 12 (kota - 50 m). Diametri i pusit është Ø5500 [mm]. Pusi është i betonuar në tërë gjatësinë. Trashësia e betonit është 500 [mm], Figura 2.1.




Figura 2.1: Prerja tërthore e pusitë, enëve ngritëse: kafazeve dhe skipeve si dhe pajisjeve të pusit në minierën e Stan Tërg-ut, Mitrovicë.

Nëpër pusin kryesor kryhet transporti i njerëzve me sistemin e dy kafazeve (1), transporti i xehes me sistemin e dy skipave (2), bartja e ujit nga miniera me gypa 14" (coll) dhe me gypa 8" (coll), bartja e ajrit të komprimuar me gypa 8" (coll), bartja e energjisë elektrike (3.3 kV) me kabllo, komunikimi me horizontet e minierës përmes telefonisë fikse (kabllo 50x2x1.5 mm²) si dhe sinjalizimi dhe komunikimi me pusore (kabllo 30x2x1.5 mm²). Nëpër pusin kryesor është i vendosur edhe kalimi me shkallë, si dalje emergjente për njerëzit nga miniera.

Përveç pusit kryesor, në vitin 1981 është lëshuar në përdorim edhe pusi verior, i thelluar nga sipërfaqja (kota 800 m të lartësisë mbidetare) deri në -80 nën nivelin e horizontit IX (kota 127 m). Ky pus është ndërtuar kryesisht për nevoja të ventilimit të minierës, por njëkohësisht është përdorë edhe si pus servisi, për krahun verior të vendburimit. Për këto qëllime, në të

është vendosë makina ngritëse e sistemit KOEPE, me një kafaz dhe me kundërpeshë. Rrotat nga goma e plotë, mundësojnë lëvizjen e “butë” të kafazit dhe të kundërpeshës nëpër pusore. Në pus nuk ka traversa, por udhëzueset e çelikta, me profil katror, janë të varura në konzola. Distanca ndërmjet dy konzolave është 6 [m]. Pusi është me diametër 5 [m] dhe i betonuar në tërë gjatësinë e vet. Makina ngritëse është plotësisht i dëmtuar.

Në minierë, nga horizonti V (kota 375 m të lartësisë mbidetare) deri në pozicionin 5 m nën horizontin XII (kota – 50 m), shtrihet “pusi i verbër”, i cili me thellim i ka parapri punimeve në hapjen e horizonteve të reja. Pusi ka formën e elipsës së cunguar në të dy anët e boshtit të madh. Boshti i madh i pusit është 3.5 [m], kurse boshti i vogël 2.8 [m]. Në këtë pusore është i vendosur makina ngritëse me tambur, me një kafaz dhe me një kundërpeshë. Për transportin e njerëzve dhe materialit, pusi përdoret vetëm nga horizonti VIII deri XII. Pjesa e pusit mbi horizontin e VIII luan rolin e pirtgut. Pusi është i betonuar në tërë gjatësinë.

2.1 Kafazet për bartjen e njerëzve në pusin kryesor

Prodhuesi i kafazit të gjelbër është “VULCAN IRON WORKS” nga SHBA-ja. Kafazi është montuar në vitin 1953 dhe është shfrytëzuar deri në vitin 2005. Në Figurën 2.1 është prezantuar gjendja e kafazit i cili është përdorur për transportin e njerëzve dhe materialeve të nevojshme për minierë.

Siç shihet nga Figura 2.1 gjendja e kafit ka qenë jo e mirë për shkak të korrozionit dhe dëmtimeve mekanike që janë paraqitur në konstruksionin e tij bartës.

Duke pasur parasysh se kafazi ka për qëllim transportin e njerëzve ku siguria duhet të jetë e lartë është paraqitur nevoja që ky kafaz të zëvendësohet me kafaz të ri.





Figura 2.1: Gjendja e kafazit të gjelbër në pusin kryesor

Në vitin 2005 në Fabrikën e Pajimeve të Procesit në Mitrovicë është punuar kafazi për transportin e njerëzve dhe materialeve të minierës, Figura 2.2.



Figura 2.2: Kafazi i ri i prodhuar në Fabrikën e Pajimeve në Mitrovicë

Litari ka diametër $\varnothing 38$ [mm], me gjatësinë 2×1000 [m] i tipit Warington 6x19 (gjashtë tufa secila tufë ika nga 19 tela). Litarët janë ndërruar në vitin 2002, 2005, 2008, 2011 dhe 2014. Makina ngritëse (Figura 2.3) është e prodhuar gjithashtu nga VULCAN IRON WORKS” nga SHBA-ja e cila e ve në lëvizje motori asinkron i prodhuesit “General Electric”, me fuqi 367.75 [kW] dhe me rezistenca në qark të rotorit, Ka nëntë shkallë rezistencash, të kyçura në lidhje serike me mbështjellën e rotorit për nisjen dhe lëshimin e tij në punë. Ç’kyçja suksesive e rezistencave nga çarku i rotorit është e automatizuar, deri të arrihet numri nominal i rrotullimeve të motorit. Pranë makinës ngritëse është edhe elektromotori rezervë.



Figura 2.3: Makina ngritëse për lëvizjen e kafazit

Makina ngritëse përbëhet prej dy tambureve cilindrike dhe me dy kafaze. Tamburet normalisht janë të fiksuara për boshtin kryesor të makinës me lidhësen elastike. Tamburi i djathtë mund të ndahet nga tamburi tjetër në mënyrë që të lëvizin pavarësisht njëra nga tjetra. “Ndarja” e tambureve bëhet kur njëri nga kafazet duhet të lëvizë jashtë pikave të skajshme të rrugës normale (mbi nivelin +760 m, ose nën nivelin +15 m), ose në raste specifike kur është e domosdoshme që për pus të lëvizë vetëm njëri kafaz.

Drejtueset (udhëzueset) në pusore janë nga materiali i drurit me prerje tërthore drejtkëndëshe (160x180 [mm]) dhe të përforcuara për traversa horizontale në çdo 3000 [mm] largësi. Kafazet janë të pajisur me zinxhirë sigures, të lidhur për litari, si dhe me mekanizmin e “parashutave” në formë kthettrash, të cilat aktivizohen përmes “shufrës mbretërore”. Në Korrik të vitit 2005 kafazi i majtë (me ngjyrë të gjelbër) është zëvendësuar me kafaz të ri, Figura 2.4.



Figura 2.4: Kafazi i ri i rikonstruktuar

Diametri i tamburit të makinës ngritëse është $D = 5500$ [mm]. Distanca nga boshti i tamburit deri të aksi vertikal i pusit është $H = 62$ [m], Figura 2.5.



Figura 2.5: Tamburi ngritës i kafazit

2.2 Skipat e xehes në pusin kryesor

Prodhuesi i skipit të xehes në pusin kryesor është “VULCAN IRON WORKS” nga SHBA-ja i cili është i montuar në vitin 1953, Figura 2.6. Litari ka diametër $\text{Ø}44$ [mm] dhe gjatësinë 2×1000 [m] i tipit Warington 6x19, me thurje në të djathtë (Z/s).



Figura 2.6: Makina ngritëse për ngritjen e skipeve

Makina ngritëse për transportin vertikal të xehes nëpër pusin vertikal, ka dy motor të lidhur paralel me boshtin e makinës me fuqi secili nga 919.38 [kW] të prodhuesit “General

Electric”. Gjithashtu ka nëntë shkallë rezistencash në qark të rotorit. Sistemi i punës është me dy skipa që lëvizin në mënyrë të sinkronizuar njëri poshtë – tjetri lartë dhe anasjelltas.

Skipat rrëshqasin me rrota gome të fortë, nëpër udhëzuese të çelikut te profilit (200x200 [mm]) dhe nuk kanë ndonjë mekanizëm sigurues nga rënia e lirë, në rast të shkoputjes aksidentale të litarit.

Secili nga dy skipat në sistem, ka vëllimin efektiv prej $V = 1.49 \text{ [m}^3\text{]}$ dhe është i projektuar që me një mbushje të ngarkohen secili nga skipat me masë të dobishme prej 5.5 ton xehe.

2.3 Kafazi në pusin e verbër

Prerja tërthore e pusit të verbër është prezantuar në Figurën 2.7 (PV01). Mekanizimi i ngritëse është me një tambur cilindrike, me diametër $\text{Ø}3000 \text{ [mm]}$, në të cilën nga ana e sipërme mbështjellët litari i kafazit, kurse nga ana e poshtme çmbështjelljet litari i kundër peshës.




Figura 2.7: Prerja tërthore e pusit të verbër

Prodhuesi i kafazit në pusin e verbër është “VULCAN IRON WORKS” nga SHBA-ja i cili është i montuar në vitin 1953, Figura 2.8 (TK01) dhe Figura 2.9 (TK02 dhe TK03).




Figura 2.8: Kafazi në pusin e verbër TK01




Figura 2.9: Kafazi në pusin e verbër TK02 dhe TK 03

Elektromotori i mekanizmit të ngritjes është me fuqi 220.65 [kW] i prodhuesit “General Electric”, me rezistenca 6 shkallësh të lidhura në çarkun e rotorit.

Sistemi është me kundërpeshë (një kafaz dhe kundërpesha), me një tambure, me litarë me diametër Ø22 [mm], konstruksioni i litarit është Warington.

Sistemi i funksionimit të kësaj makine është i ngjashëm me funksionimin e makinës ngritëse për njerëz.

3 LLOGARITJA E KAFAZIT TË GJELBËRT PËR BARTJE TË NJERËZVE DHE MATERIALEVE TË NDRYSHME

Kafazet për transport të njerëzve dhe materialit në pusin kryesor të Minierës me Flotacion “Trepça” në Stan Tërg i ka siguruar bashkë me pajisjet tjera makinerike të pusores firma Amerikane VULCAN IRON WORKS, Wilkes - Barre, PA, SHBA, në vitin 1952 nëpërmjet ndërmarrjes për furnizim të pajisjeve Minerare.

Kafazi ngritës është me dy kate me mundësi të vendosjes nga një vagonth për etazh. Përbehet prej dy dyshemeve me shina për vagontha dhe kokës së kafazit, në të cilin gjendet mbajtësi kryesor i kafazit dhe mekanizmi i varjes.

Në mbajtësin kryesor është përforcuar pajisja e varjes. Dyshemeja dhe koka janë të lidhura në mbajtësin vertikal me L profile $3 \frac{1}{2}'' \times 2 \frac{1}{2}'' \times \frac{1}{4}''$ (89x63,5x6,35 [mm]) dhe U profile 8'' (203,2 [mm]), ndërsa për ta rritë ngurtësinë nga çdo anë janë dy mbajtëse diagonal $3 \frac{1}{2}'' \times 2 \frac{1}{2}'' \times \frac{1}{4}''$ (89x63,5x6,35 [mm]).

Nga anët ballore të kokës dhe dyshemesë gjinden nofullat për udhëheqje të kafazit nëpër Drejtuese. Në anët anësore të kafazit gjinden katër elementet për udhëheqje neper udhëzueset kaluese në horizontale.

Katet janë të mbyllura me dyer prej llamarine, të cilat hapen në anën e brendshme të kafazit. Dyert mund të hiqen.

Kafazi është i mbuluar me kulmin prej llamarine, me mundësi të hapjes sipas nevojës për transportin e pjesëve me gabarite më të madhe.

Kafazi është riparuar në Fabrikën e pajimeve të procesit në Mitrovicë (FPP- Mitrovicë).

Kontrollimet e tegelave të salduara janë bërë nga firma “WELDKOS” – Prishtinë me:

- metodën e ultrazërit dhe
- me penetrant.

Pas riparimit të kafazit masa e tij është rritë për 730 [kg] dhe tani është 4730 [kg]. Pajisjet lidhëse kanë mbetë të njëjta sa i përket masës së tyre, e cila është 939 [kg].

Dyshemeja

Dyshemeja përbehet prej kornizave të forta prej llamarine, të përforcuara nga ana ballore e kafazit me profil U20, ndërsa përmes me tre profile U10. Dyshemeja është e mbuluar me dërrasa bingu prej 51 [mm].

Koka e kafazit

Koka e kafazit gjithashtu është prej llamarine dhe nga ana ballore përforcohet me profile U20 me shputa të gjëra.

Mbi bartësit kryesor gjenden dy profile gjatësore kuti me dy profile UNP14, të cilët janë të salduar në mbajtësin kryesor.

Në skajet e këtyre mbajtëseve gjendet nga çdo anë distancuesit, i cili njëkohësisht është edhe përforcues i nofullës (papuçes) për udhëzimin e kafazit për rastin e ngujimit (futjes) në udhëzueset-drejtueset e bymuara (të trashura). Nën këta mbajtës gjenden edhe dy profile katërkëndësh të salduara në anën e poshtme të mbajtësit kryesor por më të shkurtër.

Profilet katërkëndëshe të epërme dhe të poshtme janë të lidhura nga çdo anë me lidhje diagonale nga profilet UNP14, të cilët janë të salduar për profilet katërkëndësh.

Konstruksioni është shumë i ngurtë dhe mund pa dëmtim t'i bartë goditjet e kafazit në (distancues).

Në mes të dy profileve UP10" (250mm) të mbajtësit kryesor është montuar elementi, nëpër të cilin kalon shufra e mbretit. Ky element është i përforcuar fort me saldim për mbajtësin 10".

3.1 Pajisja lidhëse

Pajisjet lidhëse janë konstruktuar sipas normativave të DIN-it. Për shkak të thellësisë së madhe të pusorës dhe litarëve të rënd në pajisjet lidhëse janë paraparë elementet me çerniera, kryqet me aksëza (spinota) tërthor. Nëpërmjet të këtyre çernierave zvogëlohen lëkundjet e litarit të cilat ndikojnë negativisht në materialin e shufrës së mbretit.

Te përdorimi i këtyre elementeve me spinota kryqëzorë rekomandohet përdorimi i urave lidhëse në horizonte, sepse mund të vjen deri të lëshimi i tepërt i litarit që ka për pasojë

lakimin e pajisjes lidhëse në spinota. Kur shtrëngohet litari i paraparë nuk është e sigurt se pajisja lidhëse prapë mund të barazohet. Në rast se kjo nuk ndodh, pajisja lidhëse është në rrezik që të deformohet.

Pajisja lidhëse mund të përdoret edhe pa elementet me çerniera dhe kryqet me aksëza (spinota) tërthor, me kusht që zemra duhet të lidhet me shufrën e mbretit vetëm me ndihmën e lidhëseve. Meqenëse gjatë punës janë vërejtur lëkundje të mëdha është përdor rasti i dytë (pa to).

3.1.1 Shufra e mbretit, kryqi, lidhëset, zemra dhe spinotat

Shufra e mbretit në pjesën e poshtme është e zgjeruar në formë të pirunit për pranimin e sustës me fletë të pajisjes për kapjen e kafazit.

Nën sustë gjendet shufra me kanalet për pykë, në të cilët në levë fiksohet susta dhe kanalet për levat e pajisjes për kapje.

Në anën e epërme të shufrës së mbretit përfordhet me spinot kryqi i cili ka në fund pirunin, ndërsa në anën e epërme me prerjen katërkëndëshe të kthyer kah pirunët për 90°.

Në këtë prerje të kryqit të parë vijnë pirunët e kryqit të dytë, ndërsa në anën e epërme të tij përfordhen lidhëset. Lidhëset lidhen për zemër.

Për sigurimin e litarit në zemër, nëpërmjet pjesës së ngushtuar të zemrës futet dhe pikohet mansheta.

Spinotat janë të siguruar me pyka në formë të kunjit siguroese.

3.1.2 Shtrëngueset e litarit

Litari i ka 8 shtrënguese të tij. Në mënyrë që litari sa më tepër të mbrohet nga deformimet në vendet ku shtrëngohen shtrëngueset duhet të përshtaten profilit të litarit. Ndarja në mesë të dy fundeve të litarit pengon kontaktin e telave të litarit. Ndemjet këtyre shtrëngueseve, në litarë përfordhet shtrënguesja speciale për lidhjen e zinxhirëve siguroes.

Te pajisja lidhëse me dy kryqe kjo shtrënguese vendoset në mes të shtrënguesit të dytë dhe të tretë, ndërsa të pajisja pa kryq vendoset në mes të shtrënguesit të pestë dhe të gjashtë.

3.1.3 Zinxhirët siguroes

Kafazi është i siguruar me dy zinxhirë, të cilët me shtrënguesen speciale janë të përforduar për litar, dhe për kafazet me spinot nëpërmjet mbajtëseve në mes të anëve ballore të kokës së kafazit.

3.2 Pajisja për kapjen e kafazit

Kafazin e kapin kthetrat me brisqe në drejtimin e rrëshqitjes së kafazit. Kthetrat janë të vendosura në dy traj gjatësor.

Energjinë e nevojshme për kapjen e kafazit për drejtuese e jep susta me fletë në pozitën e saj gjatësore në kafaz.

3.2.1 Susta

Susta është sustë me fletë. Lamelat në mes janë të lidhura në pako me kapëse me krahë të cilët shtrëngohet me bulona. Për shkak të funksionimit më të mirë dhe më të sigurt, lamelat në mes nuk janë të shpuara për bulonin qendror. Në fundet e sustave gjinden rrotëzat e vogla në mënyrë që ti zvogëlojnë humbjet e energjisë për shkak të fërkimit në mbështetës.

Susta mbështetet në mbështetës të sipërm të përforcuar në profilet katrore gjatësore të kokës së kafazit. Mbështetësit janë të përshtatshëm për rregullimin e ngarkimit të rregullt të sustës.

3.2.2 Levat, trau, kthetrat

Levat nëpërmes të pirujve të shufrës së mbretit janë të siguruara ndaj zhvendosjes me spinotat e veçantë.

Levat në trarë janë të përforcuara me pyka. Lidhëset të cilat i lidhin levat janë të përforcuara me spinota.

Kthetrat në tra janë të lidhura me pyka. Çdo kthetër i ka nga katër tehe (brisqe). Në mënyrë që kthetrat më shpejtë të futën në udhëzueset-drejtueset e drurit, në pjesën e sipërme të brisqeve gjinden dhëmbët. Gjatë rrotullimit të kthetrës këta dhëmb të parët kapin udhëzueset e drurit duke e futur kthetrën në thellësi të drurit.

3.3 Verifikimi statik i kafazit për bartjen e njerëzve dhe materialit

Konstruksioni i kafazit i cili është llogaritur është paraqit në mënyrë skematike në Figurën 3.1.




Figura 3.1: Paraqitja skematike e konstruksionit bazë të kafazit

3.3.1 Llogaritja e elementeve të veçanta të kafazit gjatë transportit të materialit

Në llogaritje do të merret vetëm transporti i materialit në njërin kat (etazh) të kafazit dhe atë në katin e poshtëm.

Të dhënat e nevojshme:

- Masa e kafazit para rekonstruktimit: $m_{kaf} = G = 4000$ [kg],
- Masa e kafazit pas rekonstruktimit: $m_{kaf} = G = G_1 = 4730$ [kg]
- Masa e konstruksionit të kafazit: $m_1 = G_1 = 4730$ [kg]
- Masa e elementeve lidhëse të kafazit: $m_2 = G_2 = 936$ [kg]
- Masa vetjake e vagonthit: $m_v = L = 800$ [kg]
- Masa e xehes në vagonth: $m_d = \gamma \cdot k_m \cdot V = N = 2800$ [kg]

Sipas normativës teknike të gjitha elementet e kafazit duhet ta kenë shkallën e sigurisë me të lartë së 7.

3.3.2 Llogaritja e mbajtësve të etazhes së kafazit

Nga Figura 3.1, shihet se ngarkesa e vagonthit transmetohet nga shinat (8) në mbajtësit 3, 4, 5, 6 dhe 7.

Për të gjithë mbajtësit supozojmë se fundet e tyre janë në mbështetës. Reaksionet në mbështetësit e posaçëm i caktojmë sipas llogaritjeve që behën nga Rezistenca e Materialeve.

Sistemi i mbajtësve të Figurës 3.1 është paraqitur në Figurën 3.2.




Figura 3.2: Paraqitja skematike e sistemit të mbajtësve

Duke u nisur nga formulat e lëmisë së lartcekur fitojmë ekuacionet si në vazhdim:

$$0.380 \times Q / E \times I_8 - 0.222 \times R / E \times I_8 - 0.300 R_1 / E \times I_8 = 0.036 \times R / E \times I_4 \quad (3.1)$$

$$0.264 \times Q / E \times I_8 - 0.136 \times R / E \times I_8 - 0.213 R_1 / E \times I_8 = 0.036 \times R_1 / E \times I_5 \quad (3.2)$$

Këtyre ekuacioneve ja shtojmë edhe shprehjen nga kushti statik:

$$R + 2 R_1 + 2 R_2 = 2 \times Q \quad (3.3)$$

Ku janë shënuar me:

Q – Forca që benë presion një rrotë e vagonthës së ngarkuar në kokën e shinës,

R – Reaksioni që lajmërohet në pikën ku mbështetet shina me mbajtësin 4,

R₁ – Reaksioni që lajmërohet në pikën ku mbështetet shina me mbajtësin 3 ose 5,

R₂ – Reaksioni që lajmërohet në pikën ku mbështetet shina me mbajtësin 6 ose 7,

I₄, I₅, I₈ – Momenti i inercionit i prerjes tërthore të mbajtësit 4, 5 dhe 8 dhe

E – moduli i elasticitetit për çelik (E = 2.1x10⁶ [daN/cm²])

Shina (8) i përgjigjet shinës 70/10 me moment te inercioni të prerjes tërthore I₈ = 100 [cm⁴].

Mbajtësit 3, 4 dhe 5, të gjithë janë U profile të njëjta me lartësi 4 ” (100 [mm]) të cilët janë të përforcuar me një lamelë (30x15 [mm]) qe ka masën 10 kg/m për copë’.

Momenti i inercionit të prerjes tërthore të këtij profili (Figura 3.3) sipas teoremës së Shtajnerit është:

$$I_4 = I_c + I_{\square}' = 160 + A \times Y_c^2 = 160 + 3.0 \times 1.5 \times (5.0 + 0.75)^2 = 308.78 \text{ [cm}^4\text{]} \quad (3.4)$$




Figura 3.3: Prerja tërthore e profileve të përforcuar me lamela

Pas bartjes së të dhënave në shprehjet e lart përmendura fitojmë shprehjet në vazhdim:

$$38 \times Q = 30 \times R_1 + 23.4 \times R \quad (3.5)$$

$$26.4 \times Q = 22.5 \times R_1 + 13.6 \times R \quad (3.6)$$

Pas zgjidhjes së sistemit të ekuacioneve fitojmë të panjohurat:

$$R = 0.094 \times Q \text{ dhe} \quad (3.7)$$

$$R_1 = 0.86 \times Q \quad (3.8)$$

Nga shprehja:

$$2 \times R_2 + 2R_1 + R = 2 \times Q \quad (3.9)$$

rrjedhë se:

$$R_2 = 0.093 \times Q \quad (3.10)$$

Ngarkesën më të madhe e bartin mbajtësit 3 dhe 5, të cilët verifikohen në bazë të sforcimit maksimal në përkulje (Figura 3.4).




Figura 3.4: Mbajtësi 3 dhe 5

Momenti maksimal i përkuljes është:

$$M_{\max} = R_1 \times 30 = 0.86 \times Q \times 30 \quad (3.11)$$

$$Q=(L+N)/4 (800+2800)/4=900 \text{ [daN]} \quad (3.12)$$

$$M_{\max}=0.86 \times 900 \times 30=23220 \text{ [daNcm]} \quad (3.13)$$

Momenti rezistues i profilit është

$$W=I_4/a=308.78/6 = 51.46 \text{ [cm}^3\text{]} \quad (3.14)$$

Sforcimi maksimal është:

$$\sigma_{\max} = M_{\max}/W=23220/51.46=451.2 \text{ [daN/cm}^2\text{]} \quad (3.15)$$

Koeficienti i sigurisë:

$$S = \sigma_B/\sigma_{\max} = 3700/451.2 = 8.2 > 7 \quad (3.16)$$

d.m.th. materiali i mbajtësit i cili e plotëson këtë kusht duhet ta këtë fortësinë:

$$\sigma_B = 37 \text{ [daN/mm}^2\text{]} = 3700 \text{ [daN/cm}^2\text{]} \quad (3.17)$$

3.3.3 Llogaritja e shufrave anësore 1 dhe 2

Forcat në shufrat e veçanta i caktojmë sipas ligjit të Hook-ut (Figura 3.5).




Figura 3.5: Forcat në shufrat e veçanta

$$P=2 \times F_2 \times \cos(\alpha) + F_1 \quad DD_1 = \Delta l_1 \quad (3.18)$$

$$P=2 \times F_1 \times S_2 \times \cos^3(\alpha) / S_1 + F_1 \quad DD_2 = \Delta l_2 \quad (3.19)$$

$$P = F_1 \times (1 + 2 \times S_2 \times \cos^3(\alpha) / S_1) \quad \Delta l_2 = \Delta l_1 \times \cos(\alpha) \quad (3.20)$$

$$F_2 \times l_2 / E \times S_2 = F_1 \times l_1 \times \cos(\alpha) / E \times S_1 \quad (3.21)$$

$$F_2 = S_2 \times F_1 \times l_1 \times \cos(\alpha) / (S_1 \times l_2) \quad (3.22)$$

$$F_2 = F_1 \times S_2 \times \cos^2(\alpha) / S_1 \quad (3.23)$$

$$F_1 = P / (1 + 2 \times S_2 \times \cos^3(\alpha) / S_1) \quad (3.24)$$

Ku janë shënuar me:

L_1 dhe L_2 – gjatësitë e shufrave të veçanta

S_1 dhe S_2 – prerja tërthore e shufrave të veçanta

Karakteristikat e profilit U20 janë:

$S_1 = 32.2$ [cm²] për $\delta = 8$ [mm] – për kafazin e rikonstruktuar

$S_1 = 21.6$ [cm²] për $\delta = 5$ [mm] – për kafazin e përdorur gjerë me tani

$S_2 = 8.7$ [cm²],

$\alpha = 8^\circ$

$$P = (G + L + N) / 2 = (4730 + 800 + 2800) / 2 = 8330 / 2 = 4165 \text{ [daN]} \quad (3.25)$$

$$F_1 = 4165 / (1 + 2 \times 8.7 \times \cos^3(8) / 21.6) = 2340 \text{ [daN]} \quad (3.26)$$

$$F_2 = (-F_1) / 2 \times \cos(\alpha) = (4165 - 2340) / 2 \times 0.99 = 903.43 \text{ [daN]} \quad (3.27)$$

Momentet maksimale për shufrat e posaçme janë:

$$\text{Shufra 1: } \sigma_1 = F_1 / S_1 = 2340 / 21.6 = 108.33 \text{ [daN/cm}^2\text{]} \quad (3.28)$$

$$\text{Shufra 2: } \sigma_2 = F_2 / S_2 = 903.43 / 8.7 = 103.84 \text{ [daN/cm}^2\text{]} \quad (3.29)$$

Vërejtje:

Llogaritja është bërë për profilin U20 me $\delta = 5$ [mm] që paraqet rastin më të pavolitshëm.

Koeficientin e sigurisë e llogarisim duke përvetësuar që profilet janë të punuara prej materialit çelik që ka fortësinë: $\sigma_B = 37$ [daN/mm²] = 3700 [daN/cm²].

$$S = \sigma_B / \sigma_1 = 3700 / 108.33 = 34.15 > 7 - \text{Plotësohet kushti} \quad (3.30)$$

3.3.4 Llogaritja e mbajtësit kryesor të kafazit (9)

Këtë mbajtës e përbejnë dy U profile me lartësi 10⁶ (254 [mm]) mbajtësi kryesor është i ngarkuar si në Figurën 3.6:




Figura 3.6: Ngarkesa në mbajtësin kryesor

Llogarisim momentet në përkulje dhe sforcimet në prerjet e veçanta:

Prerja I – I:

$$M_I = 4165 \times 65 = 270725 \text{ [daNcm]} \quad (3.31)$$

Momenti rezistues: të prerja I – I e U profilit është e salduar zilja nëpër të cilën kafazi bartë shufra e mesme, prandaj mbajtësi është përforcuar me pllakë që ka trashësinë 8 mm.

Lartësinë e pllakës e marrim të barabartë me lartësinë e profilit:

$$W_{\text{prof}} = 220 \text{ [cm}^3] \quad (3.32)$$

$$W_{\text{pllak}} = (bxh^2)/6 = (0.8 \times 25.4^2)/6 = 85 \text{ [cm}^3] \quad (3.33)$$

$$W_I = W_{\text{prof}} + W_{\text{pllak}} = 220 + 85 = 305 \text{ [cm}^3] \quad (3.34)$$

Prandaj sforcimi është:

$$\sigma_I = M_I / (2 \times W_I) = 270725 / (2 \times 305) = 443.8 \text{ [daN/cm}^2] \quad (3.35)$$

Prerja II – II:

$$M_{II} = 4165 \times (65 - 19) = 191590 \text{ [daNcm]} \quad (3.36)$$

Të kjo prerje profili është i përforcuar me pllakën 5.5”x5.5”x1/4“(140x140x25 [mm]) më vrimë që ka diametrin 3 1/32 “ për traun e pajisjes për kapje.

$$I_{II} = I_{\text{prof}} + I_{\text{pllak}} - I_{\text{vrim}} = 2800 + 2.54 \times 14^3 / 12 - 3.54 \times 7.6^3 / 12 = 3250 \text{ [cm}^4] \quad (3.37)$$

$$W_{II} = 2 \times I_{II} / 25.4 = 2 \times 3250 / 25.4 = 255 \text{ [cm}^3] \quad (3.38)$$

Sforcimi:

$$\sigma_{II} = M_{II} / (2 \times W_{II}) = 191590 / (2 \times 255) = 375 \text{ [daN/cm}^2] \quad (3.39)$$

Prerja III – III:

$$M_{III} = 4165 \times 38 = 158270 \text{ [daNcm]} \quad (3.40)$$

$$W_{III} = W_{\text{prof}} = 220 \text{ [cm}^3\text{]} \quad (3.41)$$

$$\sigma_{III} = M_{III}/(2 \times W_{III}) = 158270/(2 \times 220) = 359.7 \text{ [daN/cm}^2\text{]} \quad (3.42)$$

Koeficienti i sigurisë e llogarisim duke e marrë parasysh sforcimin më të madh dhe supozimin se materiali çelik i profilit ka fortësinë:

$$\sigma_B = 37 \text{ [daN/mm}^2\text{]} = 3700 \text{ [daN/cm}^2\text{]} \quad (3.43)$$

$$S = \sigma_B/\sigma_{\text{max}} = 3700/359.7 = \mathbf{10.28} > \mathbf{7} - \mathbf{Plotësohet kushti} \quad (3.44)$$

Vërejtje:

Gjatë provave statike dhe dinamike duhet pasur kujdes në lidhjen e salduar në pikën 1 (Figura 3.6). Pas provave të kontrollohet vizualisht dhe sipas nevojës dhe me penetrant.

Rasti kur vagontha me xehe gjendët në katin e epërm të kafazit

